

Historiku i shkollës SHFMU “Rexhep Akllapi” – Akllap

Hapja e shkollës së parë në fshatin Akllap u bë në vitin 1936 dhe ishte shkollë fetare (laike), mësimi dhe edukimi bëhej në gjuhën turke dhe arabe.

Në vitin 1947 u hapën paralelet e para në gjuhën shqipe - shkolla katër vjeqare. Nxënësit e klasëve të para ishin të moshave të ndryshme nga 7-15 vjeq.

Ndërësa në mbërëmje mësuesit e asaj kohe kanë organizuar kurse për të rritur dhe femra të cilët kishin qëllim parësor çrrënjosjen plotësisht të analfabetizmit.

Me incjativën e mësimdhënësëve, Shaip dhe Sabit Gashi u bë hapja e paraleleve të tjera, kështu klasa e pestë u hap në vitin shkollorë 1969-1970, klasa e gjashtë 70-71, klasa e shtatë 71-72 dhe kështu bëhet një shkollë e plotë tetëvjeqare me afro 200 nxënës dhe me një numër me të madh mësimdhënsish.

Një ndryshim të madh shkolla pati në vitin 1985 ku u ndërtua ndërtesa e re shkollore me të cilën edhe sot bëhet mësimi e cila i plotëson nevojat e nxënësëve dhe mësimdhënësëve për zhvillimin e procesit edukativo arsimor.

Në vitin 2004 me vendimin e MASHT-it bëhet e pavarur paralelja e ndarë fizike e shkollës sonë nga shkolla amë “Shtjefën Gjeçovi” e Janjevës. Kurse me 14.06.2005 MASHT shkollën fillore në Akllap e emron me emrin e vendasit të saj patriotik “Rexhep Akllapi”.

Tani shkolla punon me dy ndërrime të gjithë mësimdhënësit janë të kualifikuar dhe të gjithë gjatë punës përdorin metoda bashkohore të mësimdhënjës.

Është për tu thekësuar se janë bërë hapa të rëndësishëm për ngritjen e cilësisë në arsim në shkollën tonë dukuke i falenderuar grandet nga Banka Botërore paisjen me laptop dhe trajnimin e mësimdhënësëve.

Falë bashkpunimit të mirë me DKA-në shkolla jonë ka pasur fatin që të trajnohen shumë mësimdhënës. Edhe infrastrukturës i është kushtuar vëmendje e veçantë, ku u bë alsfaltimi i rrugës për në oborrin e shkollës, rregullimi i toaletave të shkollës, hapja e pusit nga një shoqatë e Katarit etj.